



Kolegji Riinvest

Zyra për planifikim akademik

Mikroekonomi I EKB0012

Bartësi i lëndës:	Lumir Abdixhiku
Email:	lumir.abdixhiku@riinvest.net
Telefoni:	038 224 322
Mësimdhënësit e Lëndës:	Rinor Kastrati

Hyrje

"Lënda Mikroekonomia I, ju ofron një program atraktiv dhe të dobishëm, por edhe mjaft angazhues për të arritur sukses në përvetësimin e saj. Në këtë lëndë ju do të njiheni me konceptet bazë mikroekonomike lidhur me pamjaftueshmërinë e burimeve ekonomike, zgjedhjen, çmimet dhe alokimin (shpërndarjen) e burimeve ekonomike të kufizuara ndaj nevojave të pakufizuara dhe konkurrente. Do të mësohet dhe analizohet sjellja e agjentëve ekonomik (individët, firma, qeveria) mënyra se si merren vendimet, çfarë ndikon në këto vendime dhe çfarë efekte kanë, në mënyrë që të jeni në gjendje të bëni një vlerësim më të mirë të vendimeve të tilla në jetën e përditshme. Do të jetë shumë atraktive analiza e tregut të mallrave / shërbimeve dhe të faktorëve të prodhimit, kushtet e ekuilibrit të tyre, eficienta ekonomike si dhe ndërhyrja qeveritare në aktivitetet ekonomike dhe çështje të tjera, të cilat do t'ju mundësojë njohjen me "mënyrën ekonomike të të menduarit". "

Qëllimet

Objektivi kryesor i lëndës është përgatitja e studentit rreth njohurive bazike të koncepteve dhe relacioneve ekonomike; e të cilat shërbejnë me tutje për zhvillimin dhe zgjerimin e dijeve ekonomike në lëndet tjera.

Rezultatet e pritura të lëndës

- Të kuptoni natyrën e problemeve ekonomike dhe si sistemi i tregut përdorë çmimet për të alokuar resurset (burimet)
 - Të shpjegoni se si bashkëveprojnë aktorët e ndryshëm në procesin e prodhimit dhe konsumit dhe si ndërhyrja qeveritare për të promovuar mirëqenien ekonomike
 - Të vlerësoni efektet e dështimit të tregut dhe të informatave joeficiente në marrjen e vendimeve nga firmat, Individët, Familjet dhe agjencionet
 - Të jeni në gjendje të aplikoni analizën ekonomike në tregje të ndryshme në aspektin mikroekonomik
- Poashtu ky modul, zhvillon shkathtësitë e: komunikimit dhe prezantimit, zgjidhjes së problemeve, punës në ekip, të shkruarit, interpretimit të numrave, tabelave dhe grafeve

Programi

Java	Tema	Aktivitetet
	Kuptimi i	

1	ekonomiksit dhe çështjet themelore të mikroekonomisë	Pamjaftueshmëria, Zgjedhja ndërmjet alternativave, Kufiri i mundësive të prodhimit, Kostoja oportune, Metodatat shkencore të studimit në mikroekonomi
2	Qasja ekonomike dhe përdorimi grafeve	Modelet në ekonomi, Analiza pozitive dhe normative, Llojet e grafeve, Variablat e varura dhe të pavarura, Lidhjet ndërmejt variablave, Konstruktimi i grafeve
3	Kërkesa, Oferta dhe Ekuilibri i Tregut	"Kërkesa dhe kurba e kërkesës, Oferta dhe kurba e ofertës, Ekuilibri i tregut, Ndikimi i ndryshimit të kërkesës ofertës dhe i ndryshimeve të njëkohshëm të tyre në ekuilibrin e tregut, Disekuilibri i tregut
4	Elasticiteti i kërkesës dhe i ofertës	Elasticiteti i kërkesës lidhur me çmimin, Faktorët që përcaktojnë elasticitetin e kërkesës lidhur me çmimin, Lloje të tjera të elasticitetit
5	Zgjedhja konsumatore dhe kërkesa	Zgjedhja racionale dhe vendimet e konsumatorit, Dobia marginale dhe kërkesa e konsumatorit, Zgjedhja e konsumatorit dhe ligji i kërkesës, Analiza ordinaliste e zgjedhjes konsumatore
6	Firmat	Objektivi i firmave dhe llojet, Ritja e kapitalit, Aspektet financiare të firmës
7	Teoria e prodhimit dhe e produktit marxhinal	"Funksioni i prodhimit në periudhë afatshkurtër, Ligji i të ardhurave zbritëse, Të ardhurat e shkallës, Faktori kohë dhe ndryshimet në teknologji, Funksioni i prodhimit në periudhë afatgjatë
8	Kostoja	"Kostot në periudha afatshkurtra, Kostot në periudha afatgjata, Kostoja oportune
9	"Përcaktimi i Çmimeve në Konkurrencën e Plotë "	Tiparet e tregut konkurrencial dhe kurba e kërkesës së firmës. Vendimet dhe oferta e firmës në një periudhë afatshkurtër.
10	Vendimet e firmës në afat të gjatë në konkurrencën e plotë	Sjellja e firmës dhe degës në periudhë afatgjatë, Konkurrenca e plotë dhe eficientia ekonomike
11	Monopoli	"Tiparet e monopolit, Maksimizimi i fitimit në firmën monopol, Eficientia në kushtet e monopolit, Diskriminimi i çmimeve, Politike shtetërore e rregullimit dhe derregullimit për kontrollin e monopolit
12	Konkurrenca monopolistike dhe Oligopoli	"Tiparet e konkurrencës monopolistike, Maksimizimi i fitimit për firmën në konkurrencë monopolistike, Oligopoli, Llojet dhe bazat e ekzistimit, Modelet e oligopolit
13	Të ardhurat dhe shpërndarja e tyre	"Bazat teorike të shpërndarjes së të ardhurave, Paga si çmim i faktorit punë, Renta si çmim i tokës, Interesi si çmim i kapitalit
14	Spektori publik	"Përse është e nevojshme ndërhyrja e shtetit në ekonomi?, Aalokimi optimal i burimeve, Të mirat publike dhe eksternalitetet, Sigurimi i drejtësisë në shpërndarje dhe kurba e Lorencit, Përdorimi i plotë i burimeve dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve

Informata shtesë 2:

"Çfarë mund t'ju lehtëson përvetësimin me sukses të lëndës? • Ju duhet të keni njohuri se cila njësi mësimore do të shtjellohet gjatë javës, prandaj kërkohet nga ju që të shikoni syllabusin dhe të lexoni njësinë mësimore paraprakisht. Më lehtë do ta kutponi ligjeratën. • Është shumë me rëndësi vijimi i rregullt i ligjëratave dhe ushtrimeve. Keni parasysh se mësimdhënësi në ligjërata dhe ushtrime mes tjerash, do të përdor edhe shembuj të tjerë praktik përveç atyre të cilët i keni në libër, do të nxitë diskutimin si dhe do t'ju udhëzoj për literaturë shtesë që mund të përdorni për të zgjeruar njohuritë e juaja. • Angazhohu aktivisht

gjatë diskutimeve në ligjëratat dhe gjatë punës në grupe. Kjo do t'ju ndihmojë të kuptoni më mirë njësinë mësimore e cila shtjellohet dhe poashtu angazhimi juaj vlerësohet. • Për çështjet të cilat nuk i keni kuptuar, çdo herë konsultoni mësuesin.

Vlerësimi:

Nr.	Lloji	Përqindja	Oblig.	Përshkrimi
1	Kolokvium	45		Kolokviumi i parë do të mbahet pas javës së shtatë të ligjëratave
2	Provimi Final	45		"Studentët të cilët kanë kaluar në kolokviumin e parë, hyjnë në provimin final vetëm për pjesën e kapitujve që nuk janë përfshirë në Kolokviumin e parë dhe vlerësohen me 45%, Studentët të cilët nuk e kanë kaluar kolokviumin e parë (apo nuk kanë hyrë në kolokviumin e parë) i nënshtrohen gjithë provimit dhe vlerësohen me 90% të pikëve. Provimi do të përmbajë: 1) pyetje të hapura, të tipit "paraqit grafikisht dhe shpjego", të temave të kërkeses, ofertes, tipeve të konkurrencës e të ngjashme, (35%); 2) pyetje të renditjes së elementeve/faktorëve/llojeve të temave të ligjeruara, (20%); 3) pyetje të llogaritjes dhe kalkulimeve matematikore në temat e prodhimit, kostove, elasticitetit, (20%); 5) Kombinime të elaborimeve të shkurtëra të termeve ekonomike dhe zgjedhjeve rumbullaksuese, (25%).
3	Pjesëmarrja	10		"Ju do të keni disa detyra nga lënda mësimore gjatë orës së ushtrimeve, të cilat ju do t'i zgjidhni në grupe punuese. Detyrat do të përpilohen nga mësuesi për çdo kapitull. Pjesëmarrja në këto detyra do të vlerësohet në bashkëpunim me asistentin e lëndës.

Kushtet e përsëritjes:

Studenti mund të zgjedhë nënshttrimin në provimin e plotë, apo pjesën përkatëse të provimit nëse është i kënaqur me rezultatin e arritur në kolokvium. Sipas rregullores së Kolegjit Riinvest, studentët obligohen të kalojnë me sukses lëndën brenda 3 afateve të provimit. Nëse studentët nuk i nënshtrohen provimit në afatin e dhënë, atëherë llogaritet se kanë shpenzuar afatin dhe mundësinë. Nëse studentët nuk arrijnë që ta kalojnë lëndën në mundësinë e parë në fund të ligjëratave, atëherë vlerësimet e mëhershme (rezultatet e kolokviumeve) gjatë ligjëratave ju ruhen deri në afatin e tretë pra afatin shtatorit. Nëse pas 3 mundësive për nënshttrim të provimit brenda një viti akademik, studentët nuk kalojnë lëndën, atëherë ata obligohen të e përsërisin sërish lëndën në vitin vijues akademik.

Burimet:

- "Mançellari, A., Hadëri, S., Kule, Dh. dhe Qirici, S. (1999), Hyrje në ekonomi"
- • Sloman, J. (2006), Economics, Prentice Hall
- • Samuelson, P. A. and Nordhaus, W. D. (2001), Economics, (17th edition), McGraw-Hill. "

Ndërtimi i ECTS-ve

Aktiviteti	Nr i oreve per Aktivitetin	
Ligjerata:	3	
Ushtrime:	2	
L+U:	70	
Seminar/praktike.:	0	
Studim i vazhdushem:	150	

Pregaditja e Provimit:	35	
Pjesemarrja ne teste:	2	
Pjesemarrja ne provimin final:	3	
Me profesorin dhe asistentin:	30	
Total Ore:	225	
ECTS:	9	